



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 13.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, PËR
SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR.”
(shqyrtimi në parim)

HYRJE

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, në mbledhjet e datave 6,7,8,9, dhe 13 nëntor 2018.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, bazuar në Kalendarin e posaçëm të Kuvendit për shqyrtimin e projektbuxhetit të shtetit të vitit 2019 dhe projektligjeve financiare që kanë lidhje me të.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Ilir Beqaj relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit bazuar në përcaktimet e nenit 78, 83, pika 1 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ky projektligj është pjesë e paketës fiskale 2019.

Projektligji shoqërohet nga 4 anekse, si pjesë përbërëse e tij dhe nga relacioni shpjegues, sipas përcaktimeve të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Të pranishëm në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin Z. Erion Luçi, zëvendësministër i ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. QËLLIMI DHE PËRMBJATJA E PROJEKTLIGJIT

Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj synojnë:

- Harmonizimin në tërësi të ligjit me ndryshimet që vetë ligji ka pësuar deri më tani, si dhe me ligjet e veçanta të miratuara, që janë ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe ligji nr. 68/2017, “Për financat vendore”, si dhe ligji nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”;
- Të sqarojë cilat janë rastet e përjashtimit nga pagesa e taksës së ndërtesës për ndërtesat e banimit për pensionistë, si dhe për ndërtesat kulturore.
- Ndryshime në nenin 27, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, duke synuar thjeshtimin e zbatimit të këtij neni.
- Riformulime lidhur me përcaktimet mbi taksën e tabelës, me qëllim që të përmbledhet në një nen të vetëm, nga dy që janë aktualisht, duke e harmonizuar dhe me aneksin 7, bashkëlidhur ligjit.
- Saktësimin e rasteve kur përdorimi i rrjeteve kabllore telefonike, ndërlidhëse, apo të shërbimit informatik u nënshtrohet tarifave vendore.
- Shfuqizimin e anekseve 4, 5 e 6, të cilët, për shkak të rregullimeve ligjore në ligjin aktual, nuk gjejnë zbatim.
- Zëvendësimin e anekseve 2, 2.1, 3 e 8, të ligjit aktual, të cilat janë të formatuara sipas ndarjes së vjetër territoriale me anekset me numrat 1, 2, 3 dhe 8, të rikonceptuara, duke zëvendësuar njëkohësisht numrat e anekseve 2 e 2.1, përkatësisht me numrat 1 e 2.

Projektligji nuk paraqet efekte në buxhetin e shtetit dhe buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

II. PROCESI I SHQYRTIMIT NË KOMISIONIN PËR VEPRIMTARITË PRODHUESE, TREGTINË DHE MJEDISIN

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrtoi projektligjin në mbledhjet e datave 6,7,8, 9 dhe 13 nëntor 2018.

Të pranishëm në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pas prezantimit të detajuar të projektligjit nga relatori i caktuar nga Komisioni, përfaqësuesit e ministrisë në mënyrë të përmblodhur prezantuan synimet e projektligjit, argumentuan në aspektin e politikave fiskale ndryshimet e propozuara dhe efektet e pritshme që këto ndryshime do të kenë në buxhetin e shtetit.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të disa grupeve të interesit, si: Shoqata Shqiptare e Investitorëve të Huaj (FIAA), Shoqata Kombëtare e Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë dhe Shoqata e Ricikluesve.

Në fjalën e tyre përfaqësuesit e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë shprehën vlerësimet e tyre për buxhetin dhe paketën fiskale 2019, duke i konsideruar si më të mirat ndër vite. Ata, gjithashtu, u shprehën se me qëllim garantimin e zbatimit të parimeve kushtetuese në vendosjen e taksave, por edhe për të shmangur ekspozimin e paparashikueshëm dhe të pajustificuar financiar të operatorëve të biznesit, projektligji duhet të specifikojë në mënyrë të qartë cilat janë rastet në të cilat Këshilli Bashkiak mund të vendosë aplikimin e taksave të jashtëzakonshme, si dhe kushtet dhe kriteret për llogaritjen dhe implementimin e këtyre taksave.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni u shpreh dakord, në parim, për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm.

RELATOR

KRYETAR

Ilir BEQAJ

Eduard SHALSI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 23.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN “PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR”.

(shqyrtimi nen për nen)

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, në mbledhjen e datës 23 nëntor 2018.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrton këtë projektligj bazuar në Kalendarin e posaçëm të Kuvendit për shqyrtimin e projektbuxhetit të shtetit të vitit 2019 dhe projektligjeve financiare që kanë lidhje me të.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit ishin përfaqësues të ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj synojnë:

- Harmonizimin në tërësi të ligjit me ndryshimet që vetë ligji ka pësuar deri më tani, si dhe me ligjet e veçanta të miratuara, që janë ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe ligji nr. 68/2017, “Për financat vendore”, si dhe ligji nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”;
- Të sqarojë cilat janë rastet e përjashtimit nga pagesa e taksës së ndërtesës për ndërtesat e banimit për pensionistë, si dhe për ndërtesat kulturore.
- Ndryshime në nenin 27, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, duke synuar thjeshtimin e zbatimit të këtij neni;
- Riformulime lidhur me përcaktimet mbi taksën e tabelës, me qëllim që të përmbledhet në një nen të vetëm, nga dy që janë aktualisht, duke e harmonizuar dhe me aneksin 7, bashkëlidhur ligjit.
- Saktësimin e rasteve kur përdorimi i rrjeteve kabllore telefonike, ndërlidhëse, apo të shërbimit informatik u nënshtrohet tarifave vendore.

- Shfuqizimin e anekseve 4, 5 e 6, të cilët, për shkak të rregullimeve ligjore në ligjin aktual, nuk gjejnë zbatim.
- Zëvendësimin e anekseve 2, 2.1, 3 e 8, të ligjit aktual, të cilat janë të formatuara sipas ndarjes së vjetër territoriale me anekset me numrat 1, 2, 3 dhe 8, të rikonceptuara, duke zëvendësuar njëkohësisht numrat e anekseve 2 e 2.1, përkatësisht me numrat 1 e 2.

Projektligji nuk paraqet efekte në buxhetin e shtetit dhe buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komision, relatori u shpreh lidhur me nevojën për një ndryshim në aneksin 1 “Kategoritë minimale dhe nivelet treguese të taksës vendore mbi pasurinë e paluajtshme tokë bujqësore”. Propozohet të bëhet ky ndryshim pasi, megjithëse është ndryshuar titulli i tabelës, klasifikimi në 4 kategori i territoreve, për efekt të llogaritjes së taksës mbi tokën bujqësore, ka mbetur përsëri në bazë rrethi.

Klasifikimi i territoreve në bazë rrethi ka sjellë shqetësime tek disa bashki të vogla që deri më tani kanë zbatuar një taksë bazuar në kategorinë e rrethit ku kanë qenë dikur, ndërsa po sipas këtij klasifikimi, nga viti i ardhshëm do të kalojnë në kategorinë më të ulët. Kështu, Bashkitë Divjakë, Konispol, Roskovec, Selenicë, Himarë, Shijak do të kalojnë nga Kategoria 1 në Kategorinë 4 duke rrezikuar të mbledhin 4 herë më pak të ardhura, ndërsa Bashkitë Cërrik, Belsh, Urë Vajguore, Vau i Dejës do të kalojnë nga Kategoria 2 në Kategorinë 4 duke rrezikuar të mbledhin 3 herë më pak të ardhura.

Meqenëse rrethet janë një nocion që nuk ekziston më, është e domosdoshme të bëhet klasifikimi i bashkive sipas ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, por në mungesë të një studimi të plotë për ndarjen e bashkive në kategori të ndryshme, për efekt të llogaritjes së nivelit të taksës vendore për pasuritë e paluajtshme tokë bujqësore, duhet t’i qëndrojmë ndarjes së bashkive sipas rrethit të cilit i përkisnin në kohën e ndarjeve sipas rretheve.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vendosi të mbështesë propozimin e relatorit për ndryshimin e tabelës për klasifikimin sipas bashkive, në aneksin 1 të projektligjit dhe t’ia paraqesë atë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, si më poshtë:

“KLASIFIKIMI SIPAS BASHKIVE

KATEGORIA 1	KATEGORIA 2	KATEGORIA 3	KATEGORIA 4
Tiranë	Shkodër	Gjirokastrë	Bulqizë
Vorë	Vau i Dejës	Libohovë	Has

Kamëz	Elbasan	Dropull	Kukës
Durrës	Belsh	Pogradec	Tropojë
Shijak	Cërrik	Librazhd	Pukë
Kavajë	Berat	Prenjas	Fushë Arrëz
Rrogozhinë	Ura Vajgurore	Dibër	Mirditë
Krujë	Korçë	Mat	Malësi e Madhe
Lezhë	Maliq	Klos	Gramsh
Lushnjë	Kurbin	Skrapar	Kolonjë
Divjakë	Peqin	Poliçan	
Fier	Kuçovë	Mallakastër	
Roskovec	Delvinë	Devoll	
Patos	Pustec	Tepelenë	
Sarandë		Memaliaj	
Konispol		Përmet	
Finiq		Këlcyrë	
Vlorë			
Selenicë			
Himarë			

RELATOR

KRYETAR

Ilir BEQAJ

Eduard SHALSI